



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Komunitete

Nr. 02-060/01-0041707-1/24 dt. 28.06.2024

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Komunitete
Seanca e 29-të

Koha: 28.06.2024 ora 15:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Jeton Rrahmani, Xhafer Preteni, Majlinda Kurti, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi, Gazmend Asllani, Ardita Aliu, Agron Jashari, Esat Krasniqi dhe Habib Hajdini
Drejtori i DMMP-së z. Egzon Sadiku

Mungoi: Edina Sejdiu Hamzagic

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Komitetit i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot kam thirrur mbledhjen e rregullt të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Informatë nga drejtori i Drejtorisë së DMMP-së rreth pastrimit të ambientit të rregullt dhe periodik të ambientit në lagjen Adem Voca

Rendi i ditës u miratua unanimit

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht.

Pika 2

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani: në mbledhjen e kaluar jemi dakorduar që të ftojme drejtorin e ambientit z. Egzon Sadiku që të diskutojmë rreth Deponive ilegale të mbeturinave në lagjen "Adem Voca", që të dimë se arsyen se pse nuk merren mbeturinat në lagjen Adem Voca, pra ne nuk e dimë arsyen se pse nuk pastrohet ajo pjesë, a është arsyeja pagesa apo çka, pra drejtor fjalën po ua kaloj që të na jepni informatë rreth pastrimit të ambientit të rregullt dhe periodik të ambientit në lagjen Adem Voca.


Egzon Sadiku: Përsëritje për të gjithë, pastrimi sikurse në gjithë qytetin bëhet edhe në lagjen Adem Voca pra ato pastrohen si deponi ilegale edhe pse me rregull janë pika të rregullta të grumbullimit, por arsyeja se ata inkasimin e kanë në gjendje të rëndë, pra inkasimi është rreth 2 %, atëherë ne jemi të obliguar që të bëjmë pastrimin përmes kontratës së deponive ilegale. Banorët e asaj lagje dalin në qytet mbledhin mbeturina shkojnë i selektojnë, pra pjesa që ju duhet e marrin dhe e shesin ndërsa pjesën tjetër e gjuajnë për rreth kontejnerëve mandej po ju mundësohet edhe të tjerëve sikurse qytetarëve dhe kompanive që të hedhin mbeturina në atë pjesë e kështu që pastaj aty po krijohet deponi ilegale.

Kryesuesi i Komitetit z. Jeton Rrahmani: E faleminderoi drejtorin z. Egzon Sadiku për informatat e dhëna.


Mbledhja përfundoj punimet në ora 15:40 min.

**Mitrovicë
28.06.2024**

Procesmbajtës:


Afërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Komitetit


Jeton RRAHMANI